

ZKM ALBANIA

3/2024



Notizie dalla Fondazione
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO, Tirana

Lajme nga Fondacioni
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË, Tiranë

1993: Themelohet në Tiranë Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë.

1995: Poliambulanca Atë Luigji Monti fillon veprimtarinë.

2004: Hapet Universiteti Katolik.

2008: Hapet Qendra e Fizioterapisë dhe e Klinikës Dentare

2022: Fillon misioni i Spitalit të ri Katolik ZKM.

2024: **ZKMA Albania**, me këtë revistë të përmuajshme rrëfjëmë histori dhe ushqejmë ideale.


Redaksia "ZKM ALBANIA" 📍 Kompleksi Spitalor Universitar "Zoja e Këshillit të Mirë" Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë
📞 unikzkm 📧 unikzkm 🌐 www.unikzkm.al / Per kontakti 📧 pr@fzkm.org



DYQIND VJETORI I ATË MONTIT

Fondacioni ZKM i ka rrënjët e tij tek figura e Të Lumit Luigi Monti, themeluesit të komunitetit të të shuguruarve, që krijoi fondacionin në vitin 1993.

Kanë kaluar 200 vjet që nga lindja dhe pagëzimi i Luigi Montit, i cili u lind në Bovisio Masciago – pak kilometra në veri të Milanos – më 24 korrik 1825. I quajtur "At" në shenjë nderimi, Monti ishte një laik i shuguruar, infermier dhe edukator, frymëzues i një rruge origjinale fetare. I Lumi Luigi e bazoi veprën e tij në Ungjillin e Jezusit, spiritualitetin e ndjeshëm ndaj Marisë, nënës së Krishtit dhe në përkushtimin ndaj kujdesit për të sëmurët dhe stërvitjes së të rinjve, veçanërisht atyre më në nevojë. Në muajt e ardhshëm, edhe Fondacioni ynë do të kujtojë me mirënjohje këtë figurë, duke thelluar mesazhin dhe stilin e tij të jetës.



D.Mastroianni,
Busti i Atë Montit 1950,
Poliambulanca Atë Luigji Monti, Tiranë

POLIAMBULANCA

Dedikuar Atë Montit dhe e hapur në vitin 1995 në qendër të kryeqytetit shqiptar, Poliambulanca "gjeneroi" spitalin e ri.



Në rugën dinamike të Kavajës, kjo Poliambulancë përfaqëson një pikë referimi për popullsinë e Kryeqytetit, që e ka parë të lindë dhe të rritet gjatë tridhjetë viteve. E mbështetur me këmbëngulje nga Kongregata fetare e cila e themeloi atë në vite të vështira dhe të turbullta, sot ofron një shërbim shëndetësor shumë popullor dhe të vlerësuar. Poliambulanca, nën drejtimin e fr. Natalino, është rritur në mënyrë progresive për sa i përket specialistëve dhe pajisjeve mjekësore, të menaxhuar me përkushtim nga infermierët dhe stafi administrativ. Përvoja e Poliambulancës që gjeneruese e spitalit të ri, të çelur në vitin 2022 në Kompleksin ZKM në Rugën "Dritan Hoxha" dhe që sot përbën një degë të rëndësishme operative.

1 KOPSHTI I TË DREJTËVE

Ky vend përfaqëson një hapësirë takimi dhe diskutimesh ku e kaluara bëhet gjeneruese e së ardhmes.

Kujtimi i së Mirës është një mjet i fuqishëm edukues dhe shërben për të parandaluar gjenocidet dhe krimet kundër Njerëzimit. Në lidhje me këtë, në vitin 2012 Parlamenti Evropian caktoi 6 Marsin si Ditën e të Drejtëve, për të përhapur vlerat e përgjegjësisë, tolerancës dhe solidaritetit. Koncepti i të Drejtës përfshin ata të cilët, në çdo anë të botës, kanë shpëtuar jetë njerëzore në të gjitha gjenocidet, kanë mbrojtur dinjitetin njerëzor gjatë periudhave të totalitarizmit dhe kanë treguar përkushtim ndaj të mirës së përbashkët duke rrezikuar edhe jetën e tyre. I vendosur në Kompleksin e gjelbër universitar-spitalor të Fondacionit ZKM, Kopshti i të Drejtëve do të bëhet pikë referimi për studentët dhe pedagogët e Universitetit Katolik, për pacientët dhe punonjësit e kujdesit shëndetësor të Spitalit me të njëjtin emër, si dhe për familjet e tyre dhe për të gjithë vizitorët.



2 KOPSHTI I TË DREJTËVE

**I bashkohet rrjetit ndërkombëtar të Gariwo të Milanos (Gardens of the Righteous Worldwide).
"I drejti" i parë është Carlo Urbani.**

Në 20 vjetorin e themelimit të Universitetit ZKM, u inaugurua në Tiranë "Kopshti i të Drejtëve" – i pari në Shqipëri – i cili karakterizohet nga zgjedhja për të gdhendur emrin e të Drejtëve mbi gurë të ardhur nga të gjitha zonat e Vendlit, duke nënkuptuar në këtë mënyrë forcën ekzemplare dhe bukurinë e përhershme të dëshmisë. "I Drejti" i parë është mjeku Carlo Urbani, emri i të cilit është gdhendur në një nga gurët që janë vendosur në Kopshtin e të Drejtëve, me këtë motivim: *"Mjek infeksionist, i pari në botë që sinjalizoi epideminë SARS-CoV-1 (2002-03). I prekur nga virusi, vdiq në Bangkok, më 29 mars 2003, në moshën 47 vjeçare. Tregoi kompetenca dhe përgjegjësi në misionet e tij humanitare të pakufishme, duke i përkushtuar tërësisht vetveten."* Kjo vepër, shumë e dëshiruar nga Fondacioni, u projektua nga arkitektët Alfons Shtjefni dhe Claudio Radice, dhe u realizua nga kompania RGR.

3 KOPSHTI I TË DREJTËVE

U inaugurua më datë 6 mars, në një aktivitet me pjesëmarrje të lartë dhe intensiv.



Gjatë ceremonisë presidenti i Fondacionit "ZKM", fr. Ruggero Valentini tregoi rëndësinë që i kushtohet në këtë hapësirë universitare nderimit të njerëzve që frymëzojnë dhe edukojnë ndërgjegjen e brezave. Rektori i Universitetit Katolik prof. Leonardo Palombi ftoi studentët ta vizitojnë këtë hapësirë kreative dhe motivuese. Nën kryetarja e Bashkisë Ark. Frida Pashako përgëzoi Fondacionin për iniciativën novatore të ndërtimit të këtij Kopshti. Në fund, Arqipeshkvi i Dioqezës Metropolitane Tiranë-Durrës, Imzot Arjan Dodaj, theksoi vlerat shpirtërore dhe qytetare të kësaj vepre, të cilën më pas e bekoj përballë një audience të madhe dhe me intensitet emocional. Arqipeshkvi uroi që Kopshti të bëhet një vend i rëndësishëm për të gjithë qytetin.




☞ "PLIDA" FLET SHQIP

Nënshkruhet marrëveshja ndërmjet Universitetit Katolik ZKM dhe Shoqatës Dante Alighieri.

Më datë 1 shkurt u firmos marrëveshja ndërmjet Rektorit, prof. Leonardo Palombi dhe Zëvendës sekretarit të Përgjithshëm të Shoqatës Dante Alighieri, Z. Andrea Vincenzoni. Universiteti nis të operojë menjëherë si Qendër e autorizuar provimesh PLIDA (Progetto Lingua Italiana Dante Alighieri).

PLIDA njihet zyrtarisht nga Ministria Italiane e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe certifikon kompetencat e gjuhës italiane nga niveli A1 deri në nivelin C2 sipas kuadrit të përbashkët evropian të gjuhëve (QCER).



☞ JO VETËM DARKA DHE MIMOZA

Më datë 8 mars, sipas traditës së ZKM-së, gratë thanë "po", ne jemi. Burrat, pak të turpshëm...

Pas aktivitetit të datës 14 shkurt, me rastin e Shën Valentinit – me një iniciativë panoramike me titull "Dashuritë...": dashuria hyjnore, prindërore, e (pa)kushtëzuar - nuk mungoi një aktivitet i denjë as për Festën e gruas. Një program krahasimesh dhe dëshmish prezantoi disa "profesione" femërore: motra Teuta Buka si grua e shuguruar, prof. asoc. Malvina Hoxha, farmacistë, dr. Inida Ruli, kirurge dhe znj. Mimoza Agastra, përgjegjëse e bibliotekës "fr Paolo Ruatti".



NJË "MËKATAR" NË SHTËPINË TONË

Tenisi po jeton një epokë të artë dhe Universiteti ZKM po shikon rritjen e një kampioni.

Francesco Maria Missere, student i vitit të dytë në programin e studimit të Farmacisë, është gjithashtu një profesionist i talentuar në tenis. Me një karrierë që e ka çuar nëpër turne të nivelit profesionist në Turqi, Spanjë, Egjipt dhe Shqipëri, Francesco vazhdon me zell si formimin e tij akademik ashtu edhe atë sportiv. Aktualisht luan në Serinë A me skuadrën "Circolo Tennis të Bolonjës" dhe është gjithashtu kampion për vitin 2023 i Universiteteve shqiptare. Gjithashtu është duke u përgatitur për të marrë pjesë në një kompeticion evropian që do të mbahet në Hungari, në muajin korrik. Në foto: Francesco dhe kapelani i Universitetit, Atë Paschal.



MASTER NË FINANCIAL AND RISK MANAGEMENT

Një eksperiencë formimi ndërdisiplinore, unike në llojin e saj.

Masteri i përbashkët i nivelit të parë në Financial and Risk Management ndërmjet "Alma Mater" - Universiteti i Bolonjës dhe Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" bashkon dy institucione të ekselencës për të ofruar një eksperiencë formimi ndërdisiplinore unike në llojin e tij. Plani i avancuar i studimit, i zhvilluar sipas nevojave bashkëkohore të fushës së financave ndërkombëtare, sigurohet nga pjesëmarrja e pedagogëve-ekspertë të nivelit të lartë në këtë sektor. Mund të pohojmë me krenari se të diplomuarit tanë kanë arritur një sukses të dallueshëm për sa i përket punësimit, me një normë punësimi 100%, me 87% të të diplomuarve që punojnë në Shqipëri dhe 13% jashtë vendit. Bashkëpunimi mes dy universiteteve vazhdon të evoluojë, duke garantuar që masteri ynë të jetë pararojë, gjithmonë në harmoni me tendencat dhe zbulimet më të fundit.

Bashkohuni me ne në këtë aventurë të jashtëzakonshme të të nxëniet dhe të rritjes.



KISHA KATOLIKE

Konferenca Ipeshkvore e Shqipërisë ka rinovuar Këshillin e saj Presidential.

Ajër i freskët në Kishën katolike të Tokës së Shqipëronjave: në muajin shkurt është zgjedhur Këshilli i ri, i përbërë nga presidenti imzot. Gjergj Meta, nga zëvendës presidenti imzot Simon Kulli dhe nga sekretari imzot. Giovanni Peragine. Imzot. Meta deklaroi: "Falenderoj vëllezërit e mi që më thirrën në këtë shërbim tjetër për Kishën tonë në Shqipëri. Ia besojmë këtë shërbim martirëve shqiptar dhe kërkojmë ndërmjetësimin e tyre për të udhëhequr hapat tanë për të përballuar sfidat e këtyre kohëve. Duke nisur pikërisht nga të qenit një Kishë që di të dialogojë dhe thur lidhjet e bashkimit". Ju urojmë punë të mbarë nga "botaZKM".





PAQJA NUK ËSHTË ARTIFICIALE

Papa Françesku flet për marrëdhënien ndërmjet paqes dhe inteligjencës artificiale

Tema e paqes është gjithmonë aktuale dhe nuk nënkupton vetëm mungesën e luftës. Paqja është rezistenca ndaj të keqes, përkushtimi ndaj drejtësisë, kërkimi i së mirës së përbashkët. Paqja nënkupton gjithashtu kuptimin e limiteve të njëri-tjetrit, kulturën e dialogut, meditimin dhe bukurinë. Duke vazhduar një traditë të pezulluar për shkak të pandemisë Covid-19, të martën më datë 19 mars në orën 14:30, Fondacioni propozon një konferencë të thelluar mbi Mesazhin për Ditën e Paqes 2024, me bashkëpunimin e CESPIC (Qendra Evropiane e Shkencës për Paqe, Integritet dhe Bashkëpunim) dhe Grupit universitar CREI (Kultura dhe Burimet për Ekologjinë Integrale).

